

1. Informacion i përgjithshëm

Turkeshi Shpk është krijuar me datë 13/09/1995 dhe është rregjistruar në QKR me datë 15/01/1996. Statusi juridik është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë dhe Z. Sezai Turkeshi zotëron 100% të kuotave të kapitalit.

Selia e entitetit ndodhet në Durrës, Lagjia 2, Rruga: Karl Topia (Sefer Efendiu)
Objekti i veprimtarisë është sipërmarrje ndërtimi të ndryshme.

Veprimtaria e entitetit rregullohet me:

- Statut
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët Shoqëritë Tregtare",
- Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ndryshuar me Ligjin Nr. 9477, datë 09.02.2006,
- Legjislacioni Fiskal,
- Akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit Shqiptar.

Drejtimi realizohet nga asambleja e përgjithëshme, atributet e së cilës i ushtron ortaku i vetëm, njëkohësisht edhe administratori i shoqërisë Z. Sezai Turkeshi

Qarkullimi vjetor 10.491 mijë Lekë (afarizmi).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes


Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste menaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Menaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas perkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkakuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Krahasueshmeria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standarti të ri, një përmirësim në standart apo një ndryshim në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk rruad të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Gjykimet dhe vlerësimet kontabel

Nderkohe që pandemia Covid -19 ende po perhapet me shpejtesi në Shqipëri ashtu si në mbare botën, ka pasiguri të lartë mbi perhapjen dhe kohezgjatjen e kesaj pandemie në kohën e emetimit të pasqyrave financiare, për rrjedhojë drejtimi i shoqërisë nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme impaktin e mundshëm të kesaj pandemie në pasqyrat financiare të shoqërisë. Nderkohe që masat kufizuese vazhdojnë, pozicioni financiar dhe performanca e shoqërisë mund të ndikohen nga kjo situatë. Megjithatë, në datën e emetimit të këtyre pasqyrave financiare shoqëria vazhdon të operojë duke shlyer detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimesisë.

4. Politikat Kontabël


Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe rregjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kurset e këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/LEK	123,7	121,77
USD/LEK	100,84	108,64



4.2. Instrumentat Financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë:

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa rmbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhese dhe depozitat në para me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë për llogaritë mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të për llogaritë të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët rregjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën me të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si mëposhtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Vlera fillestare	5%
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera aktivev afatgjata	Vlera e mbetur	20%
Pajisje për zyrën	Vlera e mbetur	20%
Autovetura	Vlera e mbetur	20%

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çrregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.



4.5. Të ardhurat

Të ardhurat rregjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjatë të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare rregjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me format e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogarit për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.



4.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Arka	25,013,774	28,369,589
Banka	69,978	753,563
	<u>25,083,753</u>	<u>29,123,152</u>


Mjetet monetare në bankë detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në arkë	25,013,774	28,369,589
Raiffessien Euro	21,129	2,348
BKT lekë	48,849	751,215
	<u>25,083,753</u>	<u>29,123,152</u>

6. Të drejta të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Klientë për mallra, produkte e shërbime	136,257,997	127,372,276
	<u>136,257,997</u>	<u>127,372,276</u>



7. Të tjera të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Tvsh	424,890	5,642
Tatim fitimi	-	47,847
Të tjera të arkëtueshme	5,420	5,419
Garanci punimesh	19,560	19,560
Të drejta për sigurime shoqërore	-	29,016
Paradhënie e pagesë pjesore	2,575,750	1,287,875
Debitorë e kreditorë të tjerë	16,526,277	21,091,237
	<u>19,551,896</u>	<u>22,486,596</u>

8. Inventari

Gjendja e inventarit me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Materiale të para	3,093,401	-
Inventar i imët	8,388	6,430
	<u>3,101,789</u>	<u>6,430</u>



Turkeshi Shpk
 Shënime për pasqyrat financiare
 Për vitin e mbylltur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

9. Lëvizja e aktiveve të qëndrueshme dhe amortizimi

	Toka dhe Ndertesa	Instalime makineri e pajisje	Mjete Transporti	Mobilje e orendi dhe pajisje informatike	Totali
Aktive Afatgjata Materiale me 01.01.2020 (Kosto)		2,960,638		829,696	3,790,334
Amortizimi i akumuluar		(2,682,020)		(668,804)	(3,350,824)
VKN e aktiveve afatgjata materiale me 01.01.2020	-	278,618	-	160,892	439,510
Shtesa	-	9,158	-	-	9,158
Pakesime	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	(55,724)	-	(32,178)	(87,902)
Rimarrje e amortizimit	-	-	-	-	-
VKN e aktiveve afatgjata materiale me 31.12.2020	-	232,052	-	128,714	360,766



[Handwritten signature]



10. Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	4,453,127	4,152,287
	<u>4,453,127</u>	<u>4,152,287</u>

11. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore

Detyrimet ndaj punonjësve dhe Institutit të Sigurimeve të Shoqërore detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj punonjësve	342,268	43,584
Detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore	46,112	-
	<u>388,380</u>	<u>43,584</u>

12. Të pagueshme për detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Tatim mbi te ardhurat personale	11,700	2,600
Tatim fitimi	236,222	-
	<u>247,922</u>	<u>2,600</u>

13. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga shitja e punimeve dhe shërbimeve	10,491,851	10,743,110
Të ardhura të tjera	360,000	490,000
	<u>10,851,851</u>	<u>11,233,110</u>

14. Rakordimi i te ardhurave me FDP

	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Të ardhura sipas kontabilitetit	10,851,851
Të ardhura sipas FDP-ve	10,851,851
Diferenca *	-



15. Shpenzime për mallra, lëndë të parë dhe materiale

Shpenzime për blerje të lëndës së parë detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Blerje/shpenzime të materialeve të tjera	6,030,790	2,136,223
Ndryshim gjendje mallra	(3,093,401)	-
Blerje/shpenzime mallra, shërbimesh	7,708	63,661
	<u>2,945,098</u>	<u>2,199,884</u>

16. Kosto e personelit

Pagat e personelit dhe sigurimet më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Pagat e personelit	1,331,138	983,000
Sigurimet shoqerore e shendetesore	222,301	164,161
	<u>1,553,439</u>	<u>1,147,161</u>

17. Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të veprimtarisë së shfrytëzimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Të tjera	597,451	-
Të ndryshme	215,533	592
Personel nga jashtë ndërmarjes	20,000	10,000
Transferime, udhëtim, dieta	138,400	-
Transporte për blerje	198,048	-
Sherbime bankare	32,704	6,700
Penalite, gjoba, dëmshpërblime	1,701	43,666
Vlera kontabël e AQ të shitura	-	6,745,000
Tatime e taksa	-	141,536
	<u>1,203,838</u>	<u>6,947,494</u>

18. Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Diferenca pozivite nga kursi i këmbimit	20,657	-
Diferenca negative nga kursi i këmbimit	-	(25,466)
	<u>20,657</u>	<u>(25,466)</u>



19. Rezultati i vitit

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Fitimi/(Humbja) para tatimit	5,082,231	803,228
Shpenzime të pazbritshme:	-	-
Gjoha e penalitete	599,152	43,666
Të tjera	-	-
Humbje e mbartur	-	-
Fitimi i tatueshëm	5,681,383	846,894
Tatim Fitimi	284,069	42,345
Fitimi/Humbja pas tatimit	4,798,162	760,883

20. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në keto pasqyra financiare.

Mimoza Hasanaj
Finstudio ER&LED



Durrës më 25 mars 2021

Sezai Turkeshi
Përfaqësues ligjor

